


BULETINI



SHTATOR 2023



Konferenca për gjendjen e gjyqësorit dhe policisë në veri të Kosovës

OJQ ACDC organizoi konferencën për të trajtuar gjendjen e policisë dhe gjyqësorit në veri të Kosovës, pas largimit të serbëve nga institucionet. Panelistët, duke përfshirë Veton Elshani, Zëvendës Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Policisë në Mitrovicë Veriore, Lumnije Surduli, Gjykata Themelore e Mitrovicës - Administratore e Gjykatës, diskutuan ndikimet e këtij ndryshimi në sistemet ligjore dhe të zbatimit të ligjit, ndërsa Dushan Radaković, Drejtor Ekzekutiv, prezantoi analizën kërkimore të organizatës ACDC, për këtë situatë komplekse, që është e disponueshme në faqen tonë të internetit. [🔗](#)



[SRB](#)

[ENG](#)

[ALB](#)



Veton Elshani, zëvendës komandant i Njësisë Rajonale të Policisë Veri, dha njohuri për sfidat në rajon pas largimit të serbëve të Kosovës nga policia. Ai theksoi rëndësinë e angazhimit të komunitetit dhe ndërtimit të besimit midis të gjitha komuniteteve në veri për të rritur efektivitetin e forcave policore.



Lidhur me dorëheqjet e serbëve të Kosovës, Lumnije Surdulli, Administratore e Gjykatës përmendi se ka një boshllëk të dukshëm që është vështirë të plotësohet, por stafi po mundohet maksimalisht që detyrat t'i kryejë në mënyrë profesionale dhe të mbetet funksional, pavarësisht se është i mbingarkuar me punë.

"Jemi të stërngarkuar me detyra. I gjithë stafi i mbetur është i angazhuar dhe me mbështetjen që kemi marrë nga ACDC në aspektin e bashkëpunëtorëve ligjor, po mundohemi që t'i plotësojmë nevojat e palëve sa më shpejt," tha Surdulli.



Këshilli Konsultativ për Komunitete dhe të Drejtat e Pakicave:

Në konferencën e organizuar për të drejtat e pakicave në Kosovë, u theksua rëndësia e Këshillit Konsultativ për Komunitete dhe roli e mandati i tij.

Panelistët, duke përfshirë Avnija Bahtijari, Koordinator për Marrëdhënie me Publikun, Almedin Fejza, Kryetar i Grupit Punues Gjuhësor dhe Aleksandar Rapajiq, Drejtor i Programit në ACDC, shpalosën një prezantim të detajuar të rolit të Këshillit në avancimin e të drejtave të pakicave dhe theksuan nevojën për angazhim më të madh institucional dhe vëmendje ndaj rekomandimeve të tij.



Op-Ed-icionet e të rinjve mbi të drejtat e njeriut



Pesë OP-ED mbi tema të ndryshme të të drejtave të njeriut u publikuan nga individë të rinj në kuadër të projektit të mbështetur nga Fondi për Zhvillimin e Komunitetit, nëpërmjet programit HumanRightivism, financiar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida).



Në kuadër të të njëjtit projekt, filluam një fushatë për të drejtat e njeriut duke përfshirë individë nga Kosova të cilët ndanë citate dhe mesazhe me qëllim që të nënvizojnë çështjet e rëndësishme të të drejtave të njeriut në Kosovë dhe të nënvizojnë domosdoshmërinë e promovimit dhe mbrojtjes së këtyre të drejtave.



Broshurë për Parandalimin e Vërshimeve:



OJQ ACDC publikoi broshurën që trajton faktorët njerëzor që kontribuojnë në vërshimet. Kjo broshurë informative është e disponueshme në faqen tonë të internetit në tri gjuhë.



Projekti M4Y vazhdon

Në shtator, projekti i M4Y vazhdoi në pesë komuna të Kosovës. Ne zhvilluam trajnime të suksesshme për aftësitë e buta për të rinjtë vendas dhe organizuam seminare të Menaxhimit të Ciklit të Projektit për të përmirësuar aftësitë e menaxhimit të projektit.

Në shtator, ekipi ynë mori pjesë aktive në disa konferenca.



Drejtori aktual i ACDC-së, Dushan Radakovic mori pjesë në konferencën dyditore "Ndërtimi i besimit, Fuqizimi i Komuniteteve: Konferencë për Transparencën e Qeverisjes Lokale", organizuar nga OJQ Aktiv. Në ditën e dytë të konferencës, ai kontribuoi në panelin e tretë, i cili u fokusua në temën: "Nxitja e ndryshimit përmes inovacionit: Eksplorimi i metodave kreative për aktivizmin qytetar dhe strategjitë e angazhimit".

Menaxheri i programit të ACDC, Slobodan Stosic mori pjesë në konferencën e NDI-së për gjendjen e mjedisit në Kosovë. Gjatë ngjarjes, përfaqësuesit e Shoqërisë Civile dhe Ministri i Shëndetësisë dhe Zëvendësministri i Mjedisit i Kosovës diskutuan gjetjet në lidhje me gjendjen e mjedisit në Kosovë në katër panele të ndryshme.



Gjithashtu, Dushan Radakovic mori pjesë në konferencën e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë me temë "Gjuha e urrejtjes në diskursin publik".

Zyrtari i programit Lulzim Hakaj, morri pjesë në takim të organizuar nga Autoriteti Rregullativ i Pellgjeve Lumore në bashkëpunim me SKAT, për formimin e mekanizmit shumëpalësh të grupeve të interesit. Ky mekanizëm ka rol për të ofruar rekomandime tek institucionet relevante, në mbrojtje të ujërave në Kosovë. Takimi u mbajt në Ulqin, 27-29 Shtator 2023.





Iniciativa për pastrimin e brigjeve të lumit:

Në shtator, organizuam një aksion për pastrimin e brigjeve të lumit në Zubin Potok dhe Zveçan, ku vullnetarët u mbledhën për të larguar mbetjet dhe mbeturinat, duke kontribuar në ruajtjen e mjedisit natyror në zonë. Kjo iniciativë është pjesë e projektit "Fuqizimi i vetëdijes mjedisore në veri të Kosovës", i zbatuar në kuadër të programit "Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë" (MIRU-K), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatohet nga Skat Consulting Ltd. (Zvicër) në konsorcium me Agjencinë e Mjedisit Austria (EAA).

ACDC në media

Drejtori Ekzekutiv i ACDC-së, Dushan Radaković për situatën në veri të Kosovës:



INSJDER



Mbulimi mediatik i konferencës:



FOLLOW US

